A2 _ TERMAT E REFERENCES (ANEKS III)

Titulli i kontratës:	Kontraktimi i tre specialistëve në kuadër të projektit ReWood
Referenca e kontratës:	A03-3

1. Konteksti

Në kuadër të projektit ReWood, synohet zhvillimi i produkteve funksionale, estetike dhe të qëndrueshme prej druri, duke përdorur kryesisht materiale të ricikluara. Produktet e synuara përfshijnë, ndër të tjera: mobilie për ambiente të jashtme, tavolina dhe stola, struktura druri për sektorin e turizmit, çadra plazhi dhe elementë të ngjashëm, produkte funksionale dhe dekorative për hapësira rekreative, etj.

Për realizimin e projektit kërkohet kontraktimi i tre specialistëve si mëposhtë:

1. Dizajner Druri
2. Mjeshtër Druri
3. Teknik Informacioni

2. Objektivi i angazhimit

Objektivi i këtij angazhimi është të sigurojë mbështetje profesionale për:

- Konceptimin dhe projektimin e produkteve prej druri;
- Realizimin praktik, përpunimin dhe montimin e produkteve;
- Zhvillimin e pranisë digjitale dhe promovimin online të produkteve të projektit.

Tre specialistët do të punojnë në mënyrë të koordinuar për të kaluar nga ideja dhe dizajni në prototip, produkt final dhe promovim në treg.

3. Detyrat kryesore dhe kualifikimet e specialisteve

(a) Specialisti #1 - Dizajner Druri

Dizajneri i produkteve prej druri është përgjegjës për konceptimin, projektimin dhe zhvillimin e produkteve funksionale dhe estetike, duke shfrytëzuar materiale druri, përfshirë edhe materiale të ricikluara. Ky rol synon krijimin e zgjidhjeve inovative për sektorë si turizmi, mobilimi i ambienteve të jashtme dhe hapësirat rekreative.

Në kuadër të këtij pozicioni, kandidati do të angazhohet në zhvillimin e produkteve si mobilie të jashtme (tavolina, stola), struktura druri (p.sh. çadra plazhi), si dhe elementë të tjerë funksionalë dhe dekorativë, duke kombinuar estetikën me qëndrueshmërinë dhe prakticitetin.

Detyrat kryesore:

- Zhvillimi i ideve kreative dhe koncepteve për produkte të reja
- Realizimi i vizatimeve teknike dhe modeleve 3D
- Përzgjedhja e materialeve të përshtatshme dhe zgjidhjeve konstruktive
- Bashkëpunimi me ekipin teknik dhe mjeshtrin e drurit për realizimin e prototipeve
- Ndjekja e procesit nga koncepti deri në prodhimin final
- Përshtatja dhe optimizimi i dizajnit bazuar në kërkesat praktike dhe teknike

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Njohuri në programe dizajni (AutoCAD, SketchUp, Fusion 360 ose të ngjashme)
- Sens estetik i zhvilluar dhe kreativitet në dizajn
- Kuptim i proceseve të përpunimit të drurit dhe materialeve
- Aftësi për të lexuar dhe krijuar vizatime teknike
- Aftësi për të punuar në grup dhe për të menaxhuar projekte

(b) Specialisti #2 - Mjeshtër Druri

Mjeshtri i drurit është përgjegjës për përpunimin, ndërtimin dhe montimin e produkteve prej druri, duke siguruar cilësi të lartë dhe përputhje me specifikimet teknike në çdo fazë të prodhimit. Ky rol është thelbësor për realizimin praktik të projekteve, duke kthyer konceptet e dizajnit në produkte funksionale, estetike dhe të qëndrueshme.

Në kuadër të këtij pozicioni, kandidati do të angazhohet në realizimin e produkteve të ndryshme si mobilie për ambiente të jashtme (tavolina, stola), struktura druri për sektorin e turizmit (p.sh. çadra plazhi), si dhe elementë të tjerë funksionalë dhe dekorativë, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase edhe materiale të ricikluara.

Detyrat kryesore:

- Përpunimi i materialeve të drurit (prerje, formësim, montim) sipas projekteve dhe vizatimeve teknike
- Ndërtimi dhe montimi i produkteve finale me standarde të larta cilësie
- Bashkëpunimi me dizajnerin dhe ekipin teknik për zbatimin korrekt të projekteve
- Kontrolli i cilësisë dhe përfundimi i produkteve (lustrim, trajtim, përforcim)
- Mirëmbajtja dhe përdorimi korrekt i mjeteve dhe pajisjeve të punës
- Të punojë në bashkëpunim të ngushtë me ekipin tonë për një periudhë prej 1–2 muajsh në punishten tonë, me qëllim realizimin praktik të produkteve dhe ndjekjen e proceseve të prodhimit gjatë fazës së implementimit të projektit.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Përvojë praktike në përpunimin e drurit
- Njohuri në përdorimin e mjeteve dhe makinerive përkatëse
- Aftësi për të lexuar dhe zbatuar vizatime teknike
- Saktësi në punë dhe vëmendje ndaj detajeve
- Aftësi për të punuar në grup dhe për të respektuar afatet

(c) Specialisti #3 - Teknik Informacioni

Tekniku i informacionit është përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e pranisë digjitale të projektit, duke përfshirë krijimin e website-it, menaxhimin e rrjeteve sociale, optimizimin për motorët e kërkimit (SEO), krijimin e përmbajtjes dhe menaxhimin e fushatave të reklamimit online. Ky rol synon rritjen e dukshmërisë, promovimin e produkteve dhe arritjen e audiencës së synuar në mënyrë efektive.

Në kuadër të këtij pozicioni, kandidati do të kontribuojë në ndërtimin e një imazhi të qëndrueshëm dhe profesional online për produktet prej druri, duke përdorur strategji digjitale të integruara dhe të orientuara drejt rezultateve.

Detyrat kryesore:

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e website-it të projektit
- Menaxhimi i rrjeteve sociale (krijimi, publikimi dhe planifikimi i postimeve)
- Optimizimi i përmbajtjes për motorët e kërkimit (SEO)
- Krijimi i përmbajtjes digjitale (tekste, imazhe, materiale promocionale)
- Menaxhimi i fushatave të reklamimit online (Ads) dhe analizimi i performancës
- Monitorimi i trafikut dhe performancës përmes mjeteve analitike
- Bashkëpunimi me ekipin për të promovuar produktet dhe aktivitetet e projektit

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Njohuri në zhvillimin dhe menaxhimin e website-eve (WordPress, HTML/CSS, ose platforma të ngjashme)
- Njohuri në menaxhimin e rrjeteve sociale dhe marketingut digjital
- Eksperiencë në SEO dhe optimizimin e përmbajtjes online
- Aftësi në krijimin e përmbajtjes kreative dhe vizuale
- Njohuri në përdorimin e platformave të reklamimit (Google Ads, Meta Ads, etj.)

- Aftësi analitike për të interpretuar të dhënat dhe për të optimizuar rezultatet

4. Kohëzgjatja e angazhimit

Kohëzgjatja e pritshme e angazhimit është:

- Dizajner Druri: deri në 10 ditë pune sipas nevojës gjatë periudhës Korrik - Gusht 2026.
- Mjeshtër Druri: deri në 20 ditë pune praktike sipas nevojës pranë punishtes/projektit gjatë periudhës Korrik - Gusht 2026
- Teknik Informacioni: deri në 12 ditë pune sipas nevojës gjatë periudhës Korrik - Gusht 2026.

5. Kushtet e pjesëmarrjes

Për këtë procedurë tenderimi, pjesëmarrja është e hapur për të gjithë individët apo personat fizikë dhe juridikë të regjistruar të cilët janë të regjistruar sipas ligjit në Shqipëri.

6. Tenderuesi duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

(a) "**Formulari i Dorëzimit të Ofertës**", duke përfshirë "Deklaratën dhe deklarimin mbi nderin të ofertuesit", të plotësuar dhe nënshkruar siç duhet. Në rastin e një konsorciumi, formulari duhet të nënshkruhet nga drejtuesi i konsorciumit i autorizuar në mënyrën e duhur, me autorizimin përkatës të bashkëlidhur. Ku dokument të paraqitet duke përdorur modelin përkatës (*B1 - Formular i Dorëzimit të Ofertës*).

(b) **Një CV profesionale e specialistit**, ku paraqitet përvoja e punëve të ngjashme të mëparshme.

(c) **Një ofertë financiare** - duhet të paraqitet duke përdorur modelin përkatës (*B3 - Oferta Financiare*). Fletë shtesë mund të shtohen kur është e nevojshme.

(d) Dokumenti(et) e regjistrimit (ekstrakt nga regjistri tregtar) sipas rastit nëse ofertuesit janë personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të tenderit.

7. Dorëzimi i ofertave

Afati i fundit i pranimit te tenderëve/ofertave është: **22 Qershor 2026, ora 23:00**

Ofertat duhet të përgatiten në ***Anglisht ose Shqip*** dhe të ***dorëzohen me e-mail*** në të ***dy adresat*** mëposhtë:

tendersrewood@enterimpact.com dhe olgermelica10@gmail.com

8. Vlerësimi i ofertave

Do të përzgjidhet bazuar në kombinimim më të mirë cilësi (70%) dhe çmim (30%).

9. Njoftimi për dhënien e kontratës

Ofertuesi fitues do të njoftohet me email se oferta e tij është përzgjedhur.

10. Nënshkrimi i kontratës

Përpara nënshkrimit të kontratës, ofertuesi fitues duhet, nëse kërkohet, të paraqesë provat dokumentare ose deklaratat e kërkuara nga autoriteti kontraktor brenda afatit të përcaktuar. Pas marrjes së kontratës së nënshkruar nga autoriteti kontraktor, ofertuesi fitues duhet ta nënshkruajë, datojë dhe kthejë atë te autoriteti kontraktor brenda afatit të përcaktuar. Mosdorëzimi i provave të kërkuara ose mosnënshkrimi dhe moskthimi i kontratës brenda afateve të zbatueshme mund të çojë në anulimin e dhënies së kontratës dhe kalimin e saj te ofertuesi tjetër me çmimin më të ulët që është në përputhje, ose në anulimin e procedurës.

11. Anulimi i procedurës së tenderit

Autoriteti kontraktor mund ta anulojë procedurën e tenderit në çdo fazë, veçanërisht kur nuk merret asnjë ofertë e përshtatshme, kur kushtet financiare ose teknike të projektit kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore, kur zbatimi bëhet i pamundur, ose kur shkelje të detyrimeve, parregullsi apo mashtrim ndikojnë në drejtësinë ose

vlefshmërinë e procedurës. Autoriteti kontraktor nuk mban përgjegjësi për asnjë dëm që rrjedh nga një anulim i tillë.

12. Konfidencialiteti

E gjithë procedura e vlerësimit është konfidenciale, në përputhje me procedurat e Autoritetit Kontraktor për qasjen në dokumente. Vendimet e Komitetit të Vlerësimit janë kolegjiale dhe shqyrtimi i tyre zhvillohet me dyer të mbyllura. Anëtarët e Komitetit të Vlerësimit janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë. Raportet e vlerësimit dhe procesverbalet e mbajtura janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'u komunikohen ofertuesve ose ndonjë pale tjetër, përveç Autoritetit Kontraktor, Donatorit, autoriteteve ligjore dhe tatimore, sipas kërkesës së tyre.

13. Klauzolat etike dhe kodi i sjelljes

Ofertuesit duhet të respektojnë kërkesat etike të përcaktuara në dosjen e tenderit, duke përfshirë rregullat për konfliktin e interesit, të drejtat e njeriut, standardet mjedisore dhe të punës, luftën kundër korrupsionit, ndalimin e ryshfetit dhe shpenzimet e pazakonta tregtare. Çdo shkelje, parregullsi ose mashtrim mund të çojë në refuzimin e ofertës, anulimin e procedurës ose masa të tjera të zbatueshme.